



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

---

Numri i lëndës: 2022:067970  
Datë: 16.10.2024  
Numri i dokumentit: 06308873

**C.nr.207/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Alush Sinani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.H.nga Vitia rruga “Mustafë Koka” pn, kundër të paditurit S.M.ish nga fshati K. Komuna e Vitisë, tani me vendbanim të pnjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 16.10.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

**I.** Konstatohet e tërhequr padia e paditësit F.H.nga Vitia rruga “Mustafë Koka” pn, kundër të paditurit S.M.ish nga fshati K. Komuna e Vitisë, tani me vendbanim të pnjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 euro.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore

**Arsyetim**

Me datë 05.04.2022, paditësi, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit S.M.ish nga fshati K. Komuna e Vitisë, tani me vendbanim të pnjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 euro.

Gjykata me datë 18.12.2023, ka pranuar një parashtresë nga paditësi përmes së cilës, ndër të tjera e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë kundër të paditurit S.M.ish nga fshati K. Komuna e Vitisë, tani me vendbanim të pnjohur.

Mbështetur në nenin 261 par. 2 të LPK-së, ku është përcaktuar se: “Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po qe se i padituri brenda shtatë 7 ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë” si dhe në par. 3 të këtij dhe nenin 387, par. 1, pika c) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:067970  
Datë: 16.10.2024  
Numri i dokumentit: 06308873

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi, mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2022:067970, 16.10.2024  
C.nr.207/2022**

**Gjyqtari,**  
Alush Sinani

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa konform  
nenit 261.4, të LPK-së.